



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu


Nr. Prot.: 11956
Datë: 3/9/2021

Bazuar në nenin 5 dhe 6 të Rregullores së punës së Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 1/131 datë 1.6.2015, Rektori i UP-së thërret mbledhjen -XVI-të, të Senatit, me këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së Senatit të datës 22.07.2021;
2. Shqyrtimi i kërkesave për miratim të temës dhe aprovim të mentorit për kandidatët në studimet e doktoratës sipas raportit të KQSD për kandidatët nga njësitë akademike të UP-së;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës sipas raportit të KQSD për kandidatët nga njësitë akademike të UP-së;
4. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me kërkesën për angazhimin e profesorëve vizitorë për vitin akademik 2021/22 në F. Filologjisë, F. Mjekësisë dhe në F. Arteve;
5. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dhënien e titullit Doktor Nderi ("Dr. honoris causa") z. Driton Kuka, selektor i reprezentacionit të xhudos së Kosovës;
6. Marrja e vendimit për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët e tri niveleve të studimeve (Ba, Ma, PhD) të cilët e kanë kaluar dyfishin e periudhës së rregullt për diplomim;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Parlamentit të Studentëve lidhur me afatin e shtatorit dhe kushtit për regjistrim të vitit vijues;
8. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në formë virtuale, ditën e hënë më datë 06.09.2021, në orën 14.00.



Kryesues i Senatit të UP-së

Naser Sahiti
Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor